



PRANUAR ME:
ACCEPTED ON: 18.11.2022
PRIMLJENO
Nr.No.Br. 02/ 559



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS

Kuvendi i Komunës

Nr.02/ _____

Datë: 17.11.2022

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 40 paragrafi 2 shkronja (d,e), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/ 2008", në bazë të nenit 10, nenit 19, të Statutit të Komunës së Malishevës nr.01/871 datë:12.11.2008, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e -VIII- (tetë) të rregullt të mbajtur me datë: 10.11.2022 merr këtë:

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR DRAFTIMIN E MARRVESHJES ME BASHKËSINË ISLAME PËR SHËRBIMET E VARRIMIT NË KOMUNËN E MALISHEVËS

1.Me këtë vendim formohet Komisioni për draftimin e marrveshjes me Bashkësinë Islame për shërbimet e varrimit në komunën e Malishevës.

2.Mbështetur në nenin 1 të këtij vendimi Komisioni do të jetë në përbërje prej 7 antarëve:

- 1.Halil Morina-Nisma Socialdemokrate-anëtar
- 2.Burim Paqarizi-PDK-anëtare
3. Driton Kastrati -LDK-anëtar
4. Arbnore Hoti-VV-antarë
5. Eqrem Morina -AAK-antarë
6. Rifat Mazreku-Drejtor i Shërbimeve Publike
- 7.Fadil Shala- Zyrtar nga Shërbimet Publike

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës përmes Kryesuesit të Kuvendit.

4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas dërgimit në auteritetin mbikqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008", nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin e Administrativ të Akteve të Komunave, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) nr.06/2021 dhe pas shpalljes në ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet :

MAPL-së

Arkivit të Komunës

Kryesuesi i Kuvendit
Argjend Thaçi



Republika e Kosovës

Bashkësia Islame e Republikës së Kosovës

The Islamic Community of Republic of Kosova

Këshilli i Bashkësisë Islame-Malishevë

The Council of Islamic Community – Malishevë

Nr. 181/22

Datë: 10.10.2022



جمهورية كوسوفا

الإتحاد الإسلامي في كوسوفا

الوقف الإسلامي في ماليسيفا

11-10-2022

01/1742

PËR: Kryetarin e Komunës së Malishevës – z. Ekrem Kastrati
Kuvendin e Komunës së Malishevës
Komitetin për Politik dhe Financa

LËNDA: Kërkesë për vazhdimin dhe plotësimin e kontratës për shërbime të varrimit

Këshilli i Bashkësisë Islame në Malishevë kërkon nga kryetari i Komunës z. Ekrem Kastrati, Kuvendi Komunal dhe nga organet vendimmarrëse të KK në Malishevë, që të vazhdojnë marrëveshjen me Këshillin e Bashkësisë Islame në Malishevë për kryerjen e shërbimeve të varrimit në territorin e Komunës së Malishevës për periudhën dy vjeçare 01.01.2023 – 31.12.2024.

Po ashtu KBI në Malishevë duke pas parasysh rritjen e çmimeve dhe hiperinflacionit, kërkon nga Komuna e Malishevës, që marrëveshja e re për shërbime të varrimit të plotësohet dhe të përfshijë rritjen e nevojshme si dhe pikat e bashkangjitura në këtë kërkesë.

Mbesim me shpresë që kërkesa të shqyrtohet pozitivisht!



KRYETARI
Sead Paqarizi

Ndër çështjet të cilat kërkojmë që të përfshihen në marrëveshjen e re për shpenzime të varrimit janë:

1. Arkivoli të konsiderohet si shërbim i veçantë

Arsyetim:

Jemi e vetmja komunë e cila e kemi të përfshirë arkivolin në shpenzimet e shërbimeve të varrimit. Kjo po ndikon në rritjen e kostos totale të shërbimeve, veçanërisht pas rritjes së çmimeve të drurit dhe transportit.

Duke pas parasysh se arkivoli nuk konsiderohet prej elementeve të domosdoshme për kryerjen e varrimit, propozojmë që mos të përfshihet në shpenzimet e domosdoshme të shërbimeve të varrimit.

Nëse komuna e vlerëson të arsyeshme (nevojshme) vazhdimin e mbulimit të shpenzimeve për arkivol, atëherë kërkojmë që kostoja e arkivolit të konsiderohet si shtesë në shumën totale të shpenzimeve të varrimit.

2. Përfshirja e masave higjienike

Arsyetim:

Për shkak të gjendjes së krijuar nga Pandemia Covid 19, institucionet shëndetësore dhe ato të Bashkësisë Islame në vazhdimësi gjatë viteve që lamë pas kanë kërkuar të merren masat e nevojshme për mbrojtje dhe kundër përhapjes së pandemisë dhe sëmundjeve tjera ngjitëse. KBI në Malishevë gjatë kryerjes së shërbimeve të varrimit është e obliguar të respektojë këto masa si: dezinfektimi i rregullt i mjetit bartës, dezinfektimi i gasulhaneve (vendlarjes së kufomave), veshjet mbrojtëse për gasalët (pastruesit e kufomave) dhe pjesëmarrësit në pastrimin dhe bartjen e kufomës etj, të cilat po ndikojnë në rritjen e kostos së varrimeve.

Andaj kërkojmë nga Komuna e Malishevës që në marrëveshjen e re për shërbime të varrimit mundësisht të përfshihen edhe masat higjienike dhe kostoja e tyre.

3. Shuma për rast të rritet në 40% e shumës aktuale

Arsyetim:

Duke pas parasysh rritjen e çmimeve dhe të shërbimeve elementare, kostoja momentale me të gjitha elementet e përfshira (me arkivol) në marrëveshjen paraprake, tani më është e

papërballueshme. Të gjithë furnitorët kanë paralajmëruar që nga viti 2023 kontratat aktuale do të ndryshohen sipas rritjeve të çmimeve në treg.

Përveç kësaj, KBI në Malishevë gjatë realizimit të shërbimeve të varrimit po ngarkohet edhe me këto shpenzime shtesë:

- **Angazhimi i dy punëtorëve:**
 - a. Punëtori për pranimin dhe regjistrimin e rasteve -kujdestari, pranimi dhe sigurimi i materialit për shërbime të varrimit (paga mujore nga janari 2021 **425 euro**, respektivisht **5100 euro** në vit)
 - b. Punëtori për kryerjen e punëve në teren (transportimin e elementeve të varrimit) paga mujore **425 euro**, respektivisht **5100 euro**)
- **Mbulimi i shpenzimeve për rastet e fëmijëve të moshës 0-5 vjet (p.sh. 15 raste = 3450 euro)**
- **Angazhimi i punëtorëve shtesë** kur ndodhin më tepër se tri raste, në festat zyrtare dhe në vikend, në raste emergjente, apo pas orarit të punës etj (sipas vitit paraprak **1050 euro**) .
- **Kujdestaria gjatë vikendeve dhe ditëve të festave** (110 ditë nga 20 euro, total 2200)

Të gjitha këto shpenzime po krijojnë ngarkesë financiare dhe vështirësi në kryerjen e shërbimeve të varrimit për KBI në Malishevë. Andaj rritja e vlerës për 40% është e domosdoshme për mbulimin e shpenzimeve të lartcekura.

4. Të kërkohet vërtetimi i vdekjes nga KBI në Malishevë para lëshimit të aktit të vdekjes nga Komuna

Arsyetim:

Me rastin e vdekjes së një qytetari, rasti lajmërohet në KBI-në e Malishevës nga familjari. Me këtë rast evidentohen të gjitha shkaqet e vdekjes dhe procedurat e varrimit duke u mbështetur në dokumentet personale dhe deklaratën e familjarit. Më pas, sipas këtyre të dhënave personi i vdekur regjistrohet në sistemin e ministrisë përkatëse nga KBI. Kështu që KBI ka të gjitha dëshmitë për të vërtetuar se personi në fjalë kur ka vdekur, shkakun e vdekjes, kur, ku dhe nga kush është kryer shërbimi i varrimit.